

Emri i projektit: Efikasiteti energjetik në zonën ndërkufitare si faktor indikativ për politikën e mjedisit jetësor (akronim i projektit ENPOL-EE)

Partnerë të projektit: LB Komuna Pela, P52 Komuna Negotinë, PB3 Korporata për përfitime publike nga kultura dhe zhvillimi i Komunës Pela, PB4, SHMK "Shën Kiril dhe Metodij" - Negotinë

Pjesa 4.2.3 Janë realizuar ditë informative në komunën Negotinë

Në kuadër të Programit IPA për Bashkëpunim Ndërkufitar "Greqi - Republika e Maqedonisë së Veriut 2014-2020" dhe projekti i titulluar "Efikasiteti i energjisë në zonën ndërkufitare si një faktor indikativ i politikës së mjedisit jetësor" me akronimin ENPOL - EE ishin planifikuar pesë ditë informative për tema të ndryshme nga fusha e Efikasitetit të Energjisë. Dita e parë dhe e dytë e informacionit u realizuan vitin e kaluar, e para më datën 03.06.2019 dhe e dyta më datën 30.10.2019, ndërsa dita e tretë, e katërt dhe e pestë e informacionit u mbajtën këtë vit.

Dita e tretë e informacionit u mbajt më datën 07.10.2020, ndërsa dita e katërt e informacionit në komunën e Negotinës u mbajt më datën 27 tetor, 2020 dhe dita e fundit e informacionit u organizua më datën 17.11.2020. Tema e ditës së tretë të informacionit ishte: "Potencialet lokale për prodhimin e energjisë së biomasës për komunën e Negotinës dhe në zonën ndërkufitare". Në ditën e katërt të informacionit tema ishte: "Përdorimi i burimeve të qëndrueshme të energjisë dhe rëndësia e tyre" dhe dita e pestë e fundit e informacionit trajtoi temën "Përmirësimi i kapaciteteve të efikasitetit energjetik në komunat dhe promovimi i programeve të përgatitura për efikasitet energjetik në tre vitet e ardhshme".

Në të gjitha ditët e mbajtura të informacionit, përfaqësuesi i O3 "Invest" znj. Marija Aleksova mbajti një fjalim përshëndetës, dhe përfaqësuesit e ekipit të projektit prezantuan aktivitetet e implementuara në kuadër të projektit dhe masat konkrete të autoriteteve lokale në komunën e Negotinës dhe kontributin e tyre në efikasitetin energjetik dhe mjedis jetësor më të pastër. Në një prani të madhe të studentëve nga SHMK "Shën Kiril dhe Metodij", Kryetari i komunës Delkov, përfaqësues të Këshillit të Komunës së Negotinës, administratës komunale, institucioneve të tjera arsimore dhe qytetarëve të interesuar, prezantimi i temave dhe prezantimi i ekspertëve u bënë nga Profesor Dr. Dame Dimitriovski dhe Z. Metodija Sazdov.

Përveç diskutimeve të pranishme, ditët informative ishin shfrytëzuar edhe për sugjerime nga palët e prekura nëpërmjet pyetësorëve të ndarë për publikun dhe analizën e tyre.



Projekti zbatohet në kuadër të programit IPA për bashkëpunim ndërkufitar INTERREG CBC "Greqi – Republika e Maqedonisë së Veriut 2014 – 2020", me buxhet të përgjithshëm prej 849.900,15 €. Projekti është i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe nga fondet kombëtare të vendeve pjesëmarrëse.

Më shumë për ne dhe për projektin tonë, mund të gjeni në faqen e internetit në projektin e: <https://enpolee.eu/>; <http://negotino.gov.mk/>.

The project is co-funded by the European Union and by National Funds of the Countries participating in the Interreg IPA CBC Programme "Greece – Republic of North Macedonia 2014- 2020".

Emri i projektit: Efikasiteti energjetik në zonën ndërkufitare si faktor indikativ për politikën e mjedisit jetësor (akronim i projektit ENPOL-EE)


Partnerë të projektit: LB Komuna Pela, P52 Komuna Negotinë, PB3 Korporata për përfitime publike nga kultura dhe zhvillimi i Komunës Pela, PB4, SHMK “Shën Kiril dhe Metodij” - Negotinë

Në kuadër të projektit „ENPOL – EE”, nga programi për bashkëpunim ndërkufitar „INTERREG – IPA CBC Greqi – Republika e Maqedonisë së Veriut 2014 - 2020 “ më datën 17.11.2020 në Komunën Negotinë u mbajt event promovues për prezantimin e broshurës me temë “Si të përdoren resurset lokale të energjisë së rinovueshme për përmirësimin e efikasitetit energjetik”

Kopje e broshurës mund të merret në dy lokacione në Komunën Negotinë: në ndërtesën e komunës dhe në Qendrën e Kulturës “Aco Gjorçev”.

Eventi promovues u mbajt në hapësirë të hapur, duke i respektuar të gjitha protokollet për mbrojtje nga Koronavirusi.

Ndryshe Projekti “Efikasiteti Energjetik në rajonin ndërkufitar si faktor indikativ për politikën e mjedisit jetësor” me akronim „ENPOL – EE”, u realizua në bashkëpunim partneriteti me Komunën Negotinë, SHMK “Shën. Kiril dhe Metodij” - Negotinë, komuna Pela dhe Sipërmarrja publike Komunale për kulturë dhe zhvillim në Pela nga Greqia.



Emri i projektit: Efikasiteti energjetik në zonën ndërkufitare si faktor indikativ për politikën e mjedisit jetësor (akronim i projektit ENPOL-EE)

Partnerë të projektit: LB Komuna Pela, P52 Komuna Negotinë, PB3 Korporata për përfitime publike nga kultura dhe zhvillimi i Komunës Pela, PB4, SHMK “Shën Kiril dhe Metodij” - Negotinë

Në kuadër të projektit „ENPOL – EE”, nga programi për bashkëpunim ndërkombëtar „INTERREG – IPA CBC Greqi – Republika e Maqedonisë së Veriut 2014 – 2020” Komuna Negotinë organizoi event për shpërndarjen e “Çmime për praktikatat më të mira energjetike”.

Fidanë halorë dhe falënderime për pjesëmarrjen ishin ndarë në të gjitha shtëpitë dhe kompanitë që morën pjesë në ceremoninë për “Praktikat më të mira energjetike” që u mbajt pas thirrjes së hapur “Çmime për praktikatat më të mirat energjetike” të publikuar paraprakisht në faqen zyrtare të komunës Negotinë, dhe gjithashtu morën pjesë edhe qytetarët e tjerë të Komunës.

Ky aktivitet është një nga aktivitetet e shumta që u organizuan në kuadër të projektit “Efikasiteti energjetik në rajonin ndërkufitar si faktor indikativ për politikën e mjedisit jetësor” me akronimin „ENPOL – EE”, në bashkëpunim partneriteti të Komunës Negotinë, SHMK “Shën. Kiril dhe Metodij” – Negotinë, Komuna Pela dhe Ndërmarrja publike komunale për kulturë dhe zhvillim e qytetit Pela nga Greqia.

